

# Plani<sup>6</sup> 2030 VLEN

  
ALEANCA për SHQIPTARËT

  
ALTERNATIVA

  
LËVIZJA  
BESA

  
LËVIZJA  
DEMOKRATIK

# Plani<sup>6</sup> 2030 VLEN



Plani<sup>6</sup>  
2030  
VLEN

# I. SHTETI

# 1 KUSHTETUTA

- Subjektet politike të koalicionit VLEN e respektojnë ligjin dhe kushtetuetshmërinë në Maqedoninë e Veriut. Megjithatë ne kemi bindjen se kushtetuta në fuqi është e mangët, e kufizuar dhe në shumë pjesë të saj nuk i përfaqëson realitetet e sotme politike, sociale dhe etnike në vend. Andaj, është bërë i domosdoshëm ndryshimi dhe plotësimi i saj.
  
- Ne do të ndërtojmë konsensus për një kushtetutë e re, më demokratike dhe më moderne, e cila do ta rivedinojë vendin si shtet të barabartë të dy bashkësive shumicë, gjithsesi me të drejta të plota të garantuara edhe për bashkësitë pakicë, turqit, vlllehët, serbët, romët, boshnjakët, bullgarët, kroatët, malazezët, sllovenët, hebrenjtë dhe egjiptianët, sipas praktikave më të mira të Bashkimit Evropian. Kushtetuta e re do t'ia hapë derën edhe integritimit përfundimtar në Bashkimin Evropian të Maqedonisë së Veriut.

## 2 BARAZIA KOMBËTARE DHE MARRËVESHJA E OHRIT

- Synimi ynë i panegociueshëm, jo thjesht si parti e si koalicion, por si komunitet shqiptar, është barazia e plotë kushtetuese, ligjore dhe praktike.
- Shqiptarët, siç e kanë vërtetuar edhe regjistrimet e popullsisë, janë shumicë e dytë në Maqedoni dhe jo minoritet.
- Gjuha shqipe, me shkrimin dhe alfabetin e saj, duhet dhe do të jetë gjuhë shtetërore në të gjithë Maqedoninë e Veriut, tërësisht e barabartë me gjuhën maqedone. Administrata duhet të pajiset kudo me përkthyes nga gjuha shqipe, dhe kjo do të jetë e sanksionuar në ligjin për gjuhët. Qeveria e VLEN do të forcojë inspektoratin për zbatimin e ligjit për gjuhët dhe do të krijohen mekanizma ndëshkues për institucionet që nuk e respektojnë gjuhën shqipe.  
Këto çështje nuk janë kërkesa të reja, por duhet të ishin zgjidhur prej kohësh. Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e cila u arrit në vitin 2001, ishte një kompromis ku përfaqësuesit e komunitetit shqiptar lëshuan pe për hatër të kërkesave nga partnerët ndërkombëtarë dhe për shkak të vullnetit tonë për paqe. Pikat e asaj marrëveshjeje kanë patur katër vite afat që të përmbushen. Fatkeqësisht, edhe si pasojë e keq-qeverisjes, 22 vite më vonë ende ato pika nuk janë përmbushur.
- Ligji i Festave duhet të reflektojë barazi. Do të njihen plotësisht edhe festat kombëtare shqiptare.
- Përdorimi i himnit, stemës dhe flamurit kombëtar shqiptar në shkollat e në institucionet do të gëzojë të drejtën e barabartë ligjore me atë të maqedonasve.  
Asnjë prej këtyre të drejtave të barabarta nuk janë rrezik për Maqedoninë e Veriut, por thjesht krijim i kushteve për bashkëpunim e bashkëjetesë normale.

# 3

## DECENTRALIZIMI

Decentralizimi është domosdoshmëri. Ai i hap rrugën modernizimit, zhvillimit dhe bashkëjetesës paqësore. Decentralizimi është vlerë evropiane, e njëkohësisht ishte një nga shtyllat kryesore të Marrëveshjes Kornizë së Ohrit. Për të njëjtat arsye, zbatimi ka qenë i mangët dhe Maqedonia e Veriut vazhdon të jetë ndër shtetet më të centralizuara në kontinent. Dallimi zhvillimor dhe ekonomik mes regjioneve të privilegjuara nga qeveritë e kaluara dhe regjioneve me shumicë shqiptare është rritur shumë, sidomos si pasojë e mungesës të decentralizimit fiskal.

VLEN do të çojë përpara praktikën evropiane të decentralizimit komunal: më shumë buxhet dhe më shumë fuqi vendimmarrëse për komunat tona - më shumë zhvillim dhe më shumë barazi për qytetarët tanë. Modelet tona mund të jenë shtete të zhvilluara si Gjermania dhe Belgjika. Komuna, me qeverisjen e VLEN do të jetë niveli kryesor shtetëror, sa i përket investimeve, administratës, rendit civil dhe shërbimeve publike.

# 4

## REFORMA TERRITORIALE ELEKTORALE

Maqedonia e Veriut duhet të ndahet në tetë njësi elektorale, në përputhje edhe me regjionet planore.

Ndarja aktuale me gjashtë njësi prodhon pabarazi në votë, duke shkaktuar vazhdimisht nënpërfaqësim të shqiptarëve dhe nuk respekton as regjionet planore ekzistuese, as krahinat dhe komunitetet tradicionale e historike.

## 5 LIGJI PËR PËRFAQESIMIN E DREJTË DHE ADEKUAT

ata nuk duhet të jenë më pak se 31,51% në secilin institucion, sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë 2021 dhe metodologjisë aktuale në mekanizmin Balancer që buron nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Kjo vlen si në nivel të përgjithshëm në strukturën e secilit institucion, ashtu edhe në pozitat udhëheqëse.

- VLEN në qeveri do të sjellë rritjen e përfaqësimit horizontal e vertikal, në hierarkinë institucionale, me vëmendje të shtuar për disa institucione të rëndësishme, ku pjesëmarrja e shqiptarëve deri sot është thuajse inekzistente, qoftë në nivel të përgjithshëm apo në pozita drejtuese.

- Këtij fenomeni do t'i japim fund, përmes ligjit për përfaqësim të drejtë dhe adekuat, që do të përfshijë sanksione për institucionet që nuk e respektojnë parimin kushtetues por edhe do të eliminojë të gjitha përjashtimet, pengesat dhe inkonsistencat ligjore që pamundësojnë përfaqësimin e drejtë dhe të përshtatshëm të shqiptarëve

## 6 RESPEKTIMI I MERITOKRACISË

Në të gjitha nivelet, shqiptarët dhe qytetarët tjerë do të punësohen mbi bazën e meritave, mbi bazën e përgatitjes arsimore, profesionale dhe të përvojës së punës, e jo thjesht sipas librezave partiake.

## 7 GARANTIMI I TË DREJTAVE QYTETARE, JO PASIVIZIMIT TË TYRE

VLEN do të angazhohet që t'i jepet fund problemeve që shkakton i ashtuquajtimi "pasivizim" të adresave, që në fakt është pasivizim i të drejtave që ua jep kushtetuta të gjithë qytetarëve si shtetas, pavarësisht sa kohë, në cilin vend banojnë, apo janë të pastrehë.

Deri më sot pasivizimi ka ndodhur automatikisht, por riaktivizimi në më të shumtën e rasteve ka qenë shumë i mundimshëm dhe i vështirë. Me qeverinë e VLEN, procedurat e riaktivizimit do të jenë të njëjta me ato të pasivizimit, pra po aq të thjeshta dhe automatike.

## 8 REGJISTRIMI I POPULLSISË: T'I NUMËROJMË, SIÇ NA NUMËROJNË

VLEN do të angazhohet për pjesëmarrjen e barabartë të shqiptarëve në procesin e regjistrimit të popullsisë.

Ashtu siç numëruesit maqedonë dërgohen në regjionet me shumicë shqiptare për të qenë pjesë e regjistrimit të popullsisë, ashtu edhe shqiptarët do të shkojnë në regjionet me shumicë maqedone për të qenë pjesë e regjistrimit të popullsisë. Nëse njëra palë e numëron tjetrën, duhet të ndodhë edhe e anasjellta.



Plan  
2030  
VLEN

# II. KOMUNAT – NJËSIA KRYESORE E SHTETIT

## II. KOMUNAT - NJËSIA KRYESORE E SHTETIT

### 1. FUQIZIM I KOMUNAVE

1

VLEN në qeverisje garanton për praktikat evropiane të decentralizimit: më shumë autonomi fiskale dhe më shumë fuqi vendimmarrëse e kompetenca në komunat tona. Kjo do të thotë, më shumë zhvillim dhe më shumë barazi për qytetarët tanë.

Maqedonia e Veriut sot është ndër shtetet më të centralizuara në kontinent, gjë që ka rritur pabarazinë e zhvillimit rajonal, veçanërisht aty ku banojnë shqiptarët. Nevojitet një model i mirëfilltë decentralizimi, që mundëson vetëqeverisje lokale efikase dhe eficiente, e cila plotëson nevojat e qytetarëve dhe i jep fund politikës së shantazhimit dhe të kushtëzimit të komunave nga niveli qendror përmes sistemit të donacioneve dhe të investimeve nga lart poshtë. Synimi ynë kryesor është që të dyfishohen të ardhurat e komunave prej të ardhurave të përgjithshme publike, duke mundësuar autonomi fiskale të qëndrueshme për vetëqeverisjen lokale si dhe investime e zhvillim për vetë qytetarët.

2

## ZHVILLIMI I BARABARTË RAJONAL

Koalicioni VLEN garanton rritje substanciale të investimeve kapitale në rajonet më pak të zhvilluara, dhe sidomos atje ku nuk ka pasur fare investime të tilla.

Do të angazhohemi për shndërrimin e regjioneve aktuale planore në Qendra të Avancuara Administrative, ku pasqyrimi dhe shtrirja e të gjitha niveleve të pushtetit ekzekutiv (ministri, ndërmarrje publike, agjenci, drejtori, shoqëri aksionare) dhe gjyqësor (gjykata dhe prokurori të apelit) do të bëhet sipas modelit të regjioneve, e jo si modeli aktual që shkakton konfuzion dhe disbalancë.

Që të ketë barazi, duhet të ketë kompensim. Në ato regjione ku në të shkuarën është investuar më pak, tash duhet të investohet më shumë. Barazia në zhvillimin e rajoneve është e mirë e përbashkët, ajo i intereson të gjithëve, sepse sjell rritje të kohezionit shoqëror, rrit bashkëpunimin, çliron potencialin ekonomik dhe forcon bashkëjetesën e mirëqenien në Maqedoninë e Veriut.

Edhe përkundër rritjes së investimeve qendrore për zhvillim të barabartë rajonal gjatë viteve të fundit, arritja e caktuar të 1% të PBV-së mbetet shumë larg pasi që detyrimi ligjor nuk zbatohet: vetëm 7,4 milion euro janë ndarë në buxhetin e vitit 2021, dhe rreth 7,8 milion euro në buxhetin e vitit 2022, apo përafërsisht 0,05% e PBV-së. Ne do ta rishohim dhe do ta zbatojmë ligjin që parasheh që 1% e PBV-së alokohet për zhvillim të barabartë rajonal. Do të zbatohen programe specifike për regjionet planore më pak të zhvilluara nga ana e Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik dhe do të rriten kompetencat e komunave në menaxhimin e pasurive natyrore, si uji, pyjet, dhe minierat.

## REFORMA TERRITORIALE E KOMUNAVE

3

VLEN mbështet një reformë administrative territoriale për komunat e Maqedonisë së Veriut, duke reflektuar principet e qeverisjes lokale në Bashkimin Evropian.

Riorganizimi i komunave duhet të jetë në bazë të funksionalitetit. Dallimi mes komunave, duke patur parasysh demografinë, territorian, ekonominë dhe infrastrukturën, nuk duhet të jetë më i madh se 20%.

Ne qëndrojmë për zvogëlim të numrit të komunave, dhe për rritje të kompetencave të tyre. Kjo do të rrisë efikasitetin në dhënien e shërbimeve, por edhe mirëpërdorimin e buxhetit.

# 4

## BASHKËPUNIM INTENSIV NDËRKOMUNAL

Në komuna do të rrisim kapacitetet për bashkëpunim ndërkomunal, i cili do të sjellë mundësi të reja zhvillimore. Për projekte të mëdha të natyrës infrastrukturore apo të shërbimeve mjedisore, shëndetësore e arsimore, komunat do të mund të krijojnë buxhete të përbashkëta.

Me vetëiniciativë komunat tona do të formojnë ekipe të përbashkëta ekspertësh që do të aplikojnë për fondet e Bashkimit Evropian, në mbështetje të zhvillimit ekonomik, teknologjik dhe infrastrukturës.

VLEN në qeverinë qendrore do të jetë vazhdimisht zëri politik i pushtetit lokal.

# 5

## PJESËMARRJA NË ALOKIMIN E PROJEKTEVE QEVERTARE

Komuna duhet të jetë ajo që përcakton se në cilat projekte dhe ku shkojnë investimet shtetërore në nivelin lokal, e jo qeveria qendrore.

Komunat e dinë më së miri se cilat janë prioritetet dhe nevojat e natyrës zhvillimore, sociale apo mjedisore. Ato janë më të afërta me taksapaguesin, pra me qytetarin, dhe ato do të jenë vendimmarrëset. Komunat duhet të kenë buxhet të caktuar për investime kapitale infrastrukturore në bazë të numrit të popullsisë.

# 6

## KRIJIMI I EKIPEVE NDËRKOMUNALE PËR INVESTIME

Qeveria, në bashkëpunim me komunat do të krijojnë një ekip të përhershëm me ekspertë që do të hulumtojnë mundësitë dhe do të aplikojnë te partnerët ndërkombëtarë, te bankat zhvillimore apo tek shtetet donatore, për të sjellë investime në komunat me shumicë shqiptare në Maqedoni.



Plani<sup>6</sup>  
2030  
VLEN

# III. MAKRO-EKONOMIA: PËR QYTETARIN

### III. MAKRO-EKONOMIA: PËR QYTETARIN

## 1 NDËRMARRJET SHTETËRORE NË DORË TË QYTETARËVE

Qeveria do t'u shpërndajë qytetarëve 49% të aksioneve të ndërmarrjeve publike, duke mbajtur për vete 51% të aksioneve që do të mund të menaxhohen përmes modeleve koncesionarë apo PPP-ve.

Vlera e përgjithshme e ndërmarrjeve është afër 20 mld. euro, kjo do të thotë se secilit qytetar do t'i shpërndajmë aksione në vlerë prej 10.000 eurosh. Futja e kapitalit privat në ndërmarrjet shtetërore do të sjellë modernizim tek secila ndërmarrje, ndërsa shpërndarja e aksioneve te qytetarët do të sjellë dinamizim ekonomik dhe rritje të mirëqenies tek secila familje.

## 2 KRIJIMI I BANKËS SHQIPTARE

Brenda mandatit, VLEN angazhohet për krijimin kushteve për themelimin e bankave me kapital dominues shqiptar.

Synimi i Bankës Shqiptare është pakësimi i diskriminimit të deritashëm të shqiptarëve sa i përket financave, aksesit në kredi, pjesëmarrjes në tregje financiare, etj. Prandaj fokusi i kësaj Banke do të jetë financimi i bizneseve shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Por, në bashkëpunim me qeverinë e komunat, Banka Shqiptare do të mund të bëhet pjesë me formatin PPP edhe tek projektet e mëdha zhvillimore.

## 3 FORCIMI I ZONAVE TË LIRA EKONOMIKE SHQIPTARE

Synim i qeverisjes VLEN është zhvillimi i barabartë i zonave ekonomike, si në orientim të investimeve dhe në përkrahje financiare të shtetit për ndërtimin e infrastrukturës, ashtu edhe në shpërndarjen e investitorëve. Investimet e huaja direkte do të alokohen në mënyrë të barabartë në të gjitha rajonet planore me qëllim të rritjes dhe zhvillimit ekonomik të barabartë.

Do të japim status të veçantë për Zonën e Vizbegut, përmes centralizimit të kompetencave urbanistike dhe infrastrukturore në një institucion shtetëror. Do të përshpejtohet ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit, do të rregullohet dhe modernizohet infrastruktura rrugore dhe do të krijohet një linje e transportit publik në atë zonë. Përveç kësaj, do të bëhet edhe barazimi ligjor, infrastrukturor dhe investues i Zonave të Lira Ekonomike të Vizbegut, Strugës, Kërçovës, Tetovës dhe Likovës me zonat e tjera ekonomike, përmes investimeve në infrastrukturën rrugore, elektrike, kanalizim dhe ujësjellës. Njëra nga zonat ekzistente do të rikonceptohet si Zonë e Lirë Ekonomike për mërgatën, dedikuar krejtësisht bizneseve të mërgatës shqiptare: Kontributet për tre vite në Zonën e Lirë Ekonomike Shqiptare, do të paguhen nga shteti; Investuesit nga diaspora do të përfitojnë nga të gjitha benefitet që kanë investuesit e huaj. Njëra nga zonat ekzistente do të rikonceptohet si Zonë e Lirë Ekonomike Rinore, e cila do të jetë e dedikuar për bizneset e të rinjve: Kjo zonë do të ketë përparësi kryesisht në sektorët e start-up dhe teknologjisë.

# 4

## DEMOKRATIZIM ENERGJETIK

Do të rrisim subvencionet qeveritare për ta inkurajuar kursimin e energjisë dhe praktikat e mira mjedisore siç janë instalimi i paneleve fotovoltaike, rezervuarët e mbledhjes së ujit të shiut, etj., përfshirë në ndërtesat e banimit kolektiv (bashkëpronësi).

VLEN angazhohet që të gjitha familjeve t'u sigurohet e drejta të instalojnë sisteme të energjisë diellore në shtëpitë e pronat e tyre, të shesin një sasi të energjisë për një orar të caktuar gjatë secilës ditë.

Kjo do të thotë liberalizim i tregut energjetik - në përputhje me rregullativat evropiane dhe Ligjin për energjetikë të entitetëve juridikë.

Konsumatorët e vegjël, amvisëritë, prodhuesit e energjisë elektrike dhe përdoruesit e tjerë do të kenë mundësi të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, gjë që do të rrisë konkurrencën dhe do të sjellë benefite si ulja e kostos së jetesës, etj.

Ne do të implementojmë menaxhimin automatik të konsumit (smart grid).

Depërtimi gjithnjë në rritje i burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike me parashikim relativisht të vështirë të prodhimit sjell domosdoshmërinë për resurse balancuese në sistemin elektroenergjetik.

Me zbatimin e "smart-grid" do të përmirësohet në masë të konsiderueshme cilësia e menaxhimit të sistemit elektroenergjetik dhe do të jepet mundësia për sigurimin e efekteve financiare pozitive për konsumatorët.

Ne do të zhvillojmë projekte e politika në funksion të krijimit të rrjetit sekondar të gazit natyror, veçanërisht në rajonet planore më pak të zhvilluara të Republikës së Maqedonisë së Veriut, siç është ai veri-perëndimor apo Pollogu.

Masa që do të ndërmerren në ndihmë të qytetarëve, të sipërmarrjes dhe të prodhimit janë:

- Eliminimi i tarifës industriale të energjisë elektrike.
- Integrimi i automjeteve elektrike në sistemin e transmisionit të energjisë.
- Kapitalizimi shtesë i kompanive energjetike shtetërore
- Diversifikimi i kapaciteteve të prodhimit në përputhje me pikat e konsumit të energjisë
- Përditësimi i rregullt i planeve për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes me qëllim të sigurimit të lidhjes dhe shfrytëzimit optimal të kapaciteteve të prodhimit.

# 5

## INSTITUCIONET NË SHËRBIM TË QYTETARIT DHE TË BIZNESIT

Institucionet ngecin në shërbimin e qytetarëve dhe bizneseve në vend, diku si pasojë e efikasitetit të dobët, diku si pasojë e drejtimit/menaxhimit të gabuar, e diku si pasojë e mungesës së standardizimit protokollar. Kjo gjë e përkeqëson ndjeshëm klimën e të bërit biznes në vendin tonë, duke penguar dhe investimet. Reformat në institucionet publike dhe shtetërore janë të domosdoshme për të siguruar krijimin e klimës së volitshme të të bërit biznes dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Ne do të krijojmë institucionin e Avokatit të Biznesit si trup për përcaktim dhe zbatim e parimit "heshtja nënkupton pranimin e kërkesës" në procedurën administrative. Do të hapim zyra të Drejtorisë për të Ardhurat Publike në nivel të secilit rajon planor.

# 6

## GARANTIMI I TË DREJTAVE TË TË PUNËSUARVE

Përshpejtimi i investimeve në projektet infrastrukturore dhe zhvillimore, do të sjellë edhe angazhim të një numri të madh punëtorësh. Që punëtorët të mbrohen dhe të drejtat e tyre të respektohen, VLEN angazhohet për krijimin e një Gjykate të çështjeve të Punës. Kjo Gjykatë do të shqyrtojë me shpejtësi e me prioritet të gjitha pretendimet për abuzim në marrëdhëniet e punës.

Plani<sup>6</sup>  
2030  
VLEN

# IV. INFRASTRUKTURA: MODERNIZIM DHE KRIJIM

## IV. INFRASTRUKTURA: MODERNIZIM DHE KRIJIM

### 1 PLANIFIKIMI RAJONAL

Brenda dy viteve do të përfundojë planifikimi i përgjithshëm i zhvillimit territorial, urban, infrastrukturor dhe zhvillimor për komunat shqiptare.

Në fokus do të jetë krijimi i një rrjeti rrugor modern, duke filluar nga rrugët malore, rrugët dytësore, rrugët kombëtare, autostradat dhe hekurudhat.

### 2 INFRASTRUKTURA RRUGORE

VLEN do të fokusohet specifiku në përmirësimin e ndjeshëm të rrugëve që lidhin Maqedoninë me Kosovën dhe Shqipërinë si dhe në modernizimin e linjës hekurudhore për pasagjerë e mallra me Kosovën dhe Shqipërinë.

Rrugët kryesore do të jenë të digjitalizuara, me rrjet të fibrave optike. Ne do të angazhohemi për ndërtimin e shpejtë e cilësor rrugëve:

- Tetovë-Prizren, brenda dy viteve kalendarike.
- Rregullimi i rrugës dhe hapja e kalimit kufitar Llojan (Likovë) – Miratoc (Preshevë);
- Dibër-Peshkopi, brenda mandatit qeverisës.
- Port i Thatë në Strugë, brenda mandatit qeverisës.
- Rrjeti hekurudhor modern Shkup - Prishtinë dhe Shkup - Strugë - Durrës, brenda mandatit qeverisës.

Këto rrugë do të rrisin kapacitetin e tyre dhe do të jenë rrugë kombëtare, teksa do të modernizohen edhe pikëkalimet kufitare. Për zonat kufitare do të mundësojmë pajisjen me dokumentacion specifik që të mund ta kalojnë kufirin pa asnjë kontroll në të dyja anët, sipas modelit të Euroregjioneve.

# 3

## ZHVILLIM I FSHATRAVE DHE MALËSIVE

Që banorët të mos i braktisin fshatrat dhe malësitë, duhet që qeveria të mos i braktisë ato.

Qeveria VLEN angazhohet për:

- Rrugë e asfaltuar në secilin fshat
- Ujë të pijshëm në çdo fshat;
- Kanalizime në çdo fshat;
- Ndriçim publik në çdo vendbanim;
- Shkollë fillore për çdo tre fshatra;
- Shkollë e mesme për çdo dhjetë fshatra;
- Shkollat e fshatrave njësoj si ato të qyteteve do të pajisen me biblioteka, laboratorë, internet dhe pajisje të tjera mësimore e sportive;
- Një qendër mjekësore të mirëpajisur në secilin fshat apo grup fshatrash ku ka mbi 5000 banorë;
- Shërbim të specializuar mjekësor poliklinik dhe ambulant e për çdo 20.000 banorë.
- Mjekët dhe mësuesit që do të shkojnë të punojnë në fshatra, do të kenë bonus në rrogat e tyre.

# 4

## INFRASTRUKTURA E ENERGJISË

Në përputhje me rregullativat e Bashkimit Evropian, do të hartohet programi për tranzicion të drejtë dhe të sigurt energjetik, që gradualisht do të reduktojë përdorimin e lëndëve djegëse fosile për prodhimin e energjisë elektrike.

E domosdoshme për këtë është rikonceptimi i strategjisë shtetërore për energjinë, ku duhet të jepen udhëzime të qarta dhe fizibile zhvillimin e sektorit energjetik. Me rëndësi parësore është të mendohet për vijimësinë e TE Manastir që kërkon hapjen e minierave të reja të qymyrit, por duke pasur parasysh burimet e kufizuara, paralelisht duhet të hartohet programi për shfrytëzimin e impianteve ekzistuese për prodhimin e energjisë elektrike duke shfrytëzuar lëndë djegëse të tjera alternative, të tilla si gazi. Në strategji duhet të përkufizohet fizibiliteti dhe dinamika e përdorimit të lëndëve djegëse alternative në kapacitetet ekzistuese dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja të prodhimit, të tilla si gazifikimi i TE Oslomej dhe TE Negotinë, ndërtimi i RHE Çebren dhe Galishtë, ndërtimi i parqeve me erë dhe centraleve fotovoltaike deri në shkallën e menaxhimit të sigurt dhe efikas të sistemit elektroenergjetik dhe kapaciteteve dhe teknologjive të tjera të prodhimit që do të sigurojnë prodhim të besueshëm dhe sovran të energjisë elektrike duke garantuar njëkohësisht kritere strikte për prodhimin e "energjisë së pastër".

Për të siguruar shpërndarjen e energjisë elektrike, është i domosdoshëm rivitalizimi i rrjetit ekzistues të transmetimit dhe ndërtimi i largpërçuesve të rinj, si të brendshëm ashtu edhe interkonektivë. Në këtë kuptim, 110 kV ekzistues do të rivitalizohen në përputhje me strategjinë për rindërtimin/rivitalizimin e rrjetit të transmetimit. Projekti për ndërtimin e trafostacionit të ri 400 kV në Rajonin e Ohrit dhe lidhja interkonektive me Republikën e Shqipërisë, me përfundimin e ndërtimit të TS Ohër 400/110 kV dhe përfundimin e 400 kV largpërçues TS Manastir - TS Ohër - kufiri shqiptaro-maqedonas do të jetë prioritet në realizimin e programit për zhvillimin e sektorit energjetik.

Prioritet kryesor është miratimi i Ligjit të ri për energjetikë, me zbatimin e plotë të rregullativave të përshtatura që kanë të bëjnë me funksionimin e sektorit energjetik. Ky është parakushti themelor për integrimin e tregut tonë në tregun evropian unik të energjisë elektrike. Si hap i parë do të jetë vazhdimi i aktiviteteve të bashkimit të tregut (market coupling) në tregjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, e më pas me Republikën e Bullgarisë si projekte për të cilat tashmë kanë filluar aktivitetet. Procesi i bashkimit të tregut do të vazhdojë paralelisht edhe me vendet e tjera të rajonit me qëllim të krijimit të tregut unik të energjisë elektrike në të cilin do të përfitojnë qytetarët e vendit tonë.



Plani<sup>6</sup>  
2030  
VLEN

# V. MËRGATA DHE RIKTHIMI

## V. MËRGATA DHE RIKTHIMI

1

### VOTA E MËRGATËS

VLEN angazhohet për garantimin dhe lehtësimin e votimit të mërgatës, si qytetarë dhe shtetas të barabartë të RMV;  
 Modeli i Bullgarisë është i përshtatshëm për ne, në çdo qytet ku paraqiten 80 e më shumë votues, ambasada jonë në atë vend organizon votimin. Të tjerëve, u krijohet mundësia për të votuar përmes postës fizike, por edhe në mënyrë elektronike, siç e ka psh. Estonia.  
 Do të eliminohen deputetët e diasporës. Votuesit jo-rezidentë do të votojnë për listat e kandidatëve përbrenda shtetit, njëjtë si votuesit rezidentë.

2

### BASHKËQEVERISJE ME MËRGATËN

- Në kabinetin qeveritar, në disa poste zv.ministore apo në nivel drejtorish, do të afrohen kuadro nga mërgata.
- Do të krijohet Ministria e Diasporës, si sektor me përgjegjësi të plotë dhe buxhet vetanak, drejtuar prej kuadrove nga mërgata.
- Do të krijohet një strukturë e re: "Promotorë të RMV", përmes të cilës mërgimtarët do të veprojnë si ambasadorë ekonomikë dhe tërheqës investimesh. Personalitete të veçanta nga jeta publike dhe sipërmarrësve të mërgatës do të emërohen në pozitën e Konsullit të Nderit në vendet përkatëse, për të ndikuar kështu në përmirësimin e imazhit të vendit dhe komunikimit gjithëpërfshirës të mërgatës sonë me shtetet përkatëse.
- Në Universitetet Publike do të krijojmë hapësirën që kuadro nga mërgata të ligjërojnë si profesorë të ftuar apo të asociuar, qoftë edhe nga distanca.

## 3 SUBVENCIONIM I BIZNESEVE TË MËRGIMTAREVE QË KTHEHEN

VLEN angazhohet për:

- Subvencionim të taksave dhe tatimeve: për tre vitet e para të të gjithë atyre që kanë jetuar pesë vite ose më shumë jashtë vendit dhe kthehen të investojnë një shumë 50.000 euro apo më të lartë në hapjen e një biznesi të ri në Maqedoninë e Veriut.
- Përgjysmimin e tatimit mbi fitimin dhe aplikimin e sistemit të krediteve: bizneset e filluara nga mërgimtarët do të marrin rimbursim të përqindjes së taksës në bazë të sektorëve ku investojnë (me prioritet teknologjitë e reja, përpunimin e ushqimit dhe bujqësinë moderne) por edhe në bazë të punësimeve që krijojnë (me prioritet punësimin e të rinjve dhe grave).

## 4 PËR ÇIFTET E REJA, ZERO KAMATË PËR BANESAT

Kredi me zero interes për banim për çiftet e reja (me moshë mesatare nën 35 vjet).

Një nga arsyet e mërgimit është pamundësia për të dalë në një banesë të re, dhe kjo është lehtësisht e zgjidhshme në mënyrë direkte përmes Bankës Shqiptare të MV, por deri kur kjo Bankë të krijohet, nga qeveria do të subvencionohet kamata në bankat komerciale. Kjo politikë do të ndihmojë edhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të ndërtimit në vend, sektor që punëson shumë të rinj.

## 5 INVESTIME NË ARSIM E KULTURË NË MËRGATË.

Gjuha shqipe si lëndë fakultative në mërgatë. Në bashkëpunim me autoritetet e Shqipërisë dhe Kosovës, do ta rrisim përkrahjen për mësimin e gjuhës shqipe si lëndë fakultative në mërgatë, kjo bazuar në programet e përpiluara nga Shqipëria. Shkollat e mërgatës oo të pajisen me tekste e mësues, në bashkëpunim me Shqipërinë dhe Kosovën. Do të bëjmë lobim që gjuha shqipe të përfshihet si lëndë opsionale në ato vende ku ka shumë nxënës dhe studentë shqiptarë.

Zhvillimi i bashkëpunimit kulturor me mërgatën shqiptare. Veprat letrare të autorëve shqiptarë nga Maqedonia e Veriut të përkthehen në gjuhët e mëdha perëndimore me ndihmën e angazhimin e intelektualëve tanë në mërgatë, si dhe të përkrahet botimi e shpërndarja e letërsisë së mërgatës tonë te ne. Do të fokusohemi gjithashtu në prezantimin e projekteve kulturore nga shteti në mërgatë, si turne të ansambleve kulturore artistike, shfaqjeve teatrore, ekspozitave, etj.

## 6 KRIJIMI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË DIASPORËS SHQIPTARE

Në këtë Këshill do të përfaqësohen të gjitha subjektet politike shqiptare nga të gjitha trojet.

Këshilli do të jetë të evidentojë potencialin ekonomik të mërgatës shqiptare, dhe ta lidhë atë me vendlindjen, në formën e investimeve e të pjesëmarrjes politike.

Këshilli do të ketë rol të rëndësishëm në ndërtimi i politikave afatgjata kombëtare, si dhe vendosjen e vijave të kuqe në raport me politikën identitare, për shtetet ku jetojnë shqiptarët në trojet e tyre.

Këshilli do të krijohet në bashkëpunim me Kosovën dhe Shqipërinë.



Plani<sup>6</sup>  
2030  
VLEN

# VI. RINIA, ARSIMI, EDUKIMI

## VI. RINIA, ARSIMI, EDUKIMI

### 1 FËMIJET DHE TË RINJTË – LOJË, SPORT E KULTURË

Për secilin fëmijë nën 18 vjeç familja do të marrë një shtesë mujore prej 1.000 denarë, me mundësi zgjatje deri në 25 vjet për fëmijët që ndjekin arsimin sipëror.

Për çdo 1.000 banorë do të ndërtohet një terren sportiv i aksesueshëm në radhë të parë nga fëmijët.

Zotohemi për ndërtimin e 200 terreneve të reja sportive komunitare, tek vendbanimet shqiptare, brenda mandatit të parë, dhe 200 terrene të tjera në mandatin e dytë.

Do të hapim pesë qendra të reja kulturore shqiptare, ku do të ofrohen kurse për fëmijët e talentuar në muzikë, vallëzim, këngë, pikturë, skulpturë e arte të tjera, si dhe do të krijohen grupe kulturore-artistike që do të mbajnë aktivitete të përhershme në shkallë lokale, shtetërore apo edhe ndërkombëtare.

Do të sigurojmë përkrahje institucionale dinjitoze për sportistët elitarë. Klubet sportive, të cilat arrijnë rezultate të larta në gara rajonale dhe ndërkombëtare, do të përfitojnë grante speciale për të siguruar funksionimin e tyre. Sportistëve të dalluar, të cilët arrijnë rezultate të larta në gara rajonale dhe ndërkombëtare, do t'u jepet rrogë shtetërore.

### 2 ÇERDHE BASHKËNGJITUR ME SECILËN SHKOLLË FILLORE

Çerdhet ashtu si edhe shkollat do të kalojnë plotësisht nën menaxhimin e komunave.

Do të rritet ndjeshëm numri i çerdheve, gjë që do të mundësojë edhe rritjen e punësimit të grave dhe zhvillimin e hershëm të fëmijëve.

# 3

## SHKOLLAT SI QENDRA KOMUNITARE

Secila shkollë do të ketë ambientet e veta sportive e kulturore, të cilat do të jenë në funksion jo vetëm të nxënësve, por edhe të komunitetit.

Shkollat do të pajisen me biblioteka fizike por edhe me biblioteka digjitale në gjuhën shqipe, ku secili nxënës i regjistruar do të mund të ketë akses në libra vendorë apo të përkthyer.

Shkolla duhet të mundësojë qasjen në internet për çdo nxënës, dhe do të pajisen me laboratorë e teknologji të kohës sonë.

Konkurset e olimpiadat do të nxisin krijimin e programeve për nxënësit e talentuar, njësoj si edhe kampionatet sportive moshore.

# 4

## EDUKATA MORALE DHE QYTETARE – LËNDË E DETYRUESHME

Fëmijët dhe të rinjtë tanë duhet të përgatiten me qenë specialistë të mirë në fusha të ndryshme dhe anëtarë e qytetarë të mirë e aktivë në komunitetin dhe botën e vet. Për këtë nxënësit do të mësojnë vlerat e rëndësishme tradicionale dhe moderne mbi përgjegjësitë e njeriut, për vlerat familjare dhe rëndësinë e familjes, mbi parimet e përbashkëta shoqërore, mbi detyrat dhe të drejtat e individëve, qytetarëve, komuniteteve, mbi bashkëjetesën e tolerancën. Synimi i shkollave tona duhet të jetë specialisti dhe qytetari i mirë, si dhe familja e shëndoshë.

Urrejtja, diskriminimi, papërgjegjësia, duhen luftuar qysh në shkollë.

# 5

## ARSIM DHE EDUKIM KOMBËTAR

Nisur nga bindja se duke mësuar dashurinë për familjen, të afërmit dhe kombin e vet, fëmijët dhe të rinjtë tanë mësojnë dashurinë për njerëzimin, VLEN gjatë mandatit të vet do të angazhohet:

- Për unifikimin e sistemit dhe kurrikulave me Shqipërinë e Kosovën, teksa nga aspekti cilësor do të kontrollohet e të certifikohet nga institucionet e Maqedonisë së Veriut.
- Lëndët e gjuhës, letërsisë, historisë, gjeografisë e të tjera që lidhen me shoqërinë dhe kulturën, në veçanti duhet të përdorin tekste dhe kurrikula të njëjta me Shqipërinë e Kosovën.
- Do të propozojmë krijimin e një instituti të përbashkët me këto dy shtete për përpunimin e kurrikulave të këtyre lëndëve . Do të promovojmë përdorimin e këtyre lëndëve dhe teksteve edhe në shkollat e diasporës.
- Do të evidentohet dhe do të korrigjohen librat shkollorë dhe materialet akademike që promovojnë gjuhë të urrejtjes dhe paragjykime, që krijojnë përçarje ose i ofendojnë ndjenjat kombëtare të bashkësive.

# 6

## GJIMNAZ I FORTË

Mbas përfundimit të klasës së nëntë të gjithë nxënësit do të bëjnë një provim shtetëror për praninë gjimnaz. Ata që nuk e kalojnë provimin shtetëror do të orientohen drejt arsimit profesional.

Gjimnazet për teknologji dhe shkenca digjitale do të themelohen apo do të zhvillohen më tej në Shkup (ku aktualisht ekziston), Tetovë dhe Manastir. Aty do të ofrohet kurrikulë për teknologji dhe shkenca digjitale, kjo si nevojë e kohës dhe bazuar në përvojat e vendeve të zhvilluara, ku japin rezultate të suksesshme. Këto shkolla duhet të jenë qendra ekselence për fëmijë të talentuar, që e prodhojnë elitën shkencore të së ardhmes. Mësimi do të mbahet nga profesorë universitarë dhe numri i nxënësve në klasa nuk duhet do të jetë më i lartë se 15 për klasë.

# 7

## FORCIMI I ARSIMIT PRAKTIK DHE PROFESIONAL – ARSIMI DUAL

Do të vazhdohet me implementimin e arsimit dual nëpër shkollat e mesme profesionale dhe do të zgjerohet ajo me përfshirjen e të gjithë nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme profesionale të cilëve do t'u sigurohen bursa profesionale

Shkollat e mesme profesionale do të japin diploma të profesionit me licencë të kontrolluar nga shteti, gjë që do të thotë se të diplomuarit do të mund të fillojnë menjëherë punën në kompanitë private apo shtetërore.

Përcaktimi apo klasifikimi i drejtimeve për nxënësit do të bëhet qysh nga Klasa e 9-të, në shërbim të nevojave reale të tregut të punës.

Ne do të zbatojmë formulën e arsimit dual të Gjermanisë, e cila së fundi po zbatohet me sukses edhe në Kosovë. Arsimi dual mundëson që nxënësit disa orë në ditë të shkojnë për të marrë praktikë pranë bizneseve tona vendore.

# 8

## MËSUES CILESORË – FORCIMI I FAKULTETIT PEDAGOGJIK

- Do të jepen rroga për studentët cilësorë që regjistrohen në fakultetin pedagogjik.
- Do të krijojmë një qendër për trajnimin e mësuesve; në bashkëpunim me Kosovën dhe Shqipërinë. Secili mësues do të ketë detyrimin të marrë pesëdhjetë orë trajnim përgjatë secilit vit.
- Në çdo pesë vite mësuesit do të hyjnë në testim të përgjithshëm shtetëror, për të siguruar që janë në nivelin e detyrës.
- Mësuesit që kalojnë me sukses trajnimet dhe testimet do të marrin rritje prej 3% të rrogës në secilin vit pune, përveç rritjeve dhe indeksimeve të tjera që bëhen për të gjithë.
- Mësues pa diploma nuk do të lejohen më.

# 9

## IDENTIKIT I SECILËS SHKOLLE

- Secili institucion arsimor do të ketë dokumentim të plotë të rezultateve të nxënësve e të mësuesve në testimet shtetërore dhe ato ndërkombëtare.
- Do të ketë një inventar të investimeve dhe mjeteve që shkolla ka në përdorim, si dhe të gjendjes së tyre të vazhdueshme.
- Prej drejtorëve të shkollave do të kërkohet aftësi menaxheriale, dhe do të vlerësohen vetëm nëse e rrisin rankingun e shkollës së tyre vit pas viti.

# 10

## RRITJA E KUJDESIT DHE SIGURISË NË SHKOLLA

- Në shkolla do të ketë ambiente të përkushtuara për nxënësit me nevoja të veçanta.
- Shërbimi profesional nëpër shkolla do të jetë në përbërje pedagogë, psikologë, defektologë dhe punonjës socialë të diplomuar, të cilët do të ndihmojnë nxënësit, por edhe do të sinjalizojnë institucionet e familjet për çdo rast problematik.
- Në shkollat e mesme të përgjithshme do të ketë edhe një zyrë të këshillimit të karrierës, ku do të jepen këshilla profesionale për nxënësit para se ata të zgjedhin degën e studimeve universitare.
- Këto këshilla do të marrin parasysh edhe prirjet e dëshirat e nxënësit, por edhe nevojat e tregut të punës.
- Alkooli dhe droga do të mbahen strikt larg shkollave tona.

# 11

## CILËSIA UNIVERSITARE

Do të krijohet një këshill i përbashkët i universiteteve shqiptare;

Të tre Universitetet publike do nxiten të specializohen për fusha të gjera por të ndryshme:

- Njëri në shkenca ekzakte dhe inxhinierike,
- Njëri në shkenca shoqërore e humane;
- Njëri në mjekësi e shërbime sociale;

Do të miratojmë ligjin për akreditim e universiteteve private sipas standardeve evropiane.

Deri tani kemi arritur të realizojmë sasinë e universiteteve dhe studentëve shqiptarë. Tani hyjmë në fazën e rritjes së cilësisë, që studentët tanë më të mirë të mos jenë të detyruar të zgjedhin universitetet në maqedonisht për shkak të cilësisë së tyre më të lartë.

# 12

## AKADEMIA SHQIPTARE E SHKENCAVE DHE ARTEVE

Akademia do të themelohet si domosdoshmëri e kohës, për promovimin dhe studimin e kulturës, historisë, dhe vlerave të larta të shoqërisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Ky institucion do të mbetet jo-partiak, dhe do të mbledhë kontributet nga shkencëtarë e krijues shqiptarë të Maqedonisë së Veriut. Përmes financimit të studimeve dhe botimit të periodikëve shkencorë, por edhe përmes organizimit të aktiviteteve akademike, do të afirmohen vlerat tona si komunitet por edhe individët tanë me arritje të larta vendore e ndërkombëtare.



Plani  
2030  
VLEN<sup>6</sup>

# VII. MIRËQENIA DHE EKONOMIA

## VII. MIRËQENIA DHE EKONOMIA

### 1 BUXHET ZHVILLIMOR

Ristrukturimi i shpenzimeve publike: buxheti i RMV-së të përqendrohet në politikat zhvillimore, rritjen e investimeve kapitale në mesatare prej 14% në nivel vjetor, në minimum 25%; deri në 3% të BPV-së për të investuar në arsim, hulumtime dhe zhvillim, deri 3% për zhvillim të barabartë rajonal etj;

### 2 GJASHTË SPITALE RAJONALE

- Në nivelin primar do të punojmë për të hapur klinika të mjekësisë familjare për çdo 5000 banorë, përfshirë në vendet rurale dhe poliklinika për çdo 20.000 banorë;
- Në nivelin sekondar synojmë të kemi nga një spital modern për çdo 100.000 banorë.
- Në regjionet ku jetojnë shqiptarët të hapen gjashtë spitale, të cilët do të menaxhohen nga komunat. Investimi për këto spitale do të jetë ose prej buxhetit publik, ose si PPP.

### 3 SPITAL I MADH (TERCIAR) NË TETOVË

Një Qendër Klinike Universitare në Tetovë do të lidhet me fakultetet e mjekësisë në atë qytet dhe do të ofrojë shërbimin terciar për të gjithë pjesën perëndimore të Maqedonisë, duke eliminuar distancën e madhe me Shkupin, por edhe duke e çliruar prej mbingarkesës spitalin e Shkupit.

4

## SHËNDET PËR TË GJITHË

Kontrolli shëndetësor i përgjithshëm do të jetë i aksesueshëm dhe falas, një herë në vit për të gjithë qytetarët, në punë ose jo. Veç rolit parandalues, kjo dhe ul kostot e sistemit shëndetësor në vend.

Secila komunë shqiptare do të pajiset me një qendër të urgjencës dhe me auto-ambulanca.

Do të hapet qendër për trajtimin e plagëve dhe djegieve, sepse aktualisht pacientët dërgohen në Bullgari. Do të favorizohen edhe ordinancat private për sektorë që nuk i përmbush shërbimi publik, siç janë shëndetësia dentare apo ajo estetike, të cilat do të krijojnë kushtet për turizëm shëndetësor në Maqedoninë e Veriut.

5

## ASNJË PENSION MË I VOGËL SE PAGA MINIMALE

Personat që nuk kanë qenë pjesë e sigurimeve shoqërore do të marrin pensionin minimal, të barabartë me pagën minimale.

Të gjithë të tjerët do të marrin pensione më të larta. Të moshuarit të cilët dëshirojnë të punojnë edhe përtej moshës së pensionit, do të shikohet mundësia që të aktivizohen me pagë të rregullt, sipas përvojës profesionale dhe përgatitjes që ata kanë.

6

## KUOTA 40% PËR GRATE

Përfshirjen e grave në të paktën 40% të të gjitha pozicioneve të emëruara, në të gjitha nivelet.

Diskriminimin pozitiv për postet me konkurs: në rastet kur pikët janë të barabarta do të favorizohet gjinia që ka më pak prezencë në secilin vend të punës.

7

## SHTESA PRINDËRIMI

- Të gjithë familjet do të marrin 1000 denarë në muaj shtesë për secilin fëmijë, deri në moshën që ai i bën 18 vjet, me mundësi zgjatje dhe rritje deri në 1500 denarë për fëmijët që ndjekin arsimin sipëror, edhe atë deri në moshën 25 vjeçare.
- Për familjet me një prind, shuma do të jetë 1500 denarë për fëmijë.
- Për familjet që birësojnë fëmijë jetimë, shtesa do të jetë 2500 denarë në muaj.

8

## ULJA E KOSTOS SË PUNËS

Ulja e kontributeve (përlllogaritja nga Neto) në 32% nga aktualja prej 47,7%. Si rrjedhojë, në sektorin privat paga minimale neto të rritet në 30.000 denarë.

9

## MË PAK TAKSA PER BIZNESET E VOGLA DHE TË MESME

- Do të rritet pragu i tatimpaguesve të TVSH-së nga 2 milion në 3 milionë denarë, me të cilën masë do të ndikohet drejtpërdrejtë në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla;
- Do të zvogëlohet përgjysmë ngarkesa me taksa për bizneset që ofrojnë shërbime falas ose me çmim të përgjysmuar për të moshuarit.
- Nxitja e prodhimit të materialeve të ndërtimit, duke mbajtur nivelin e TVSH-së 18% në 5%;

10

## LIRIM NGA TAKSAT PËR BIZNESET E TË RINJVE

Personat më të rinj se 30 vjet që hapin biznes në Maqedoni, do të lirohen për tre vite nga taksat biznesore.

# 11

## ORGANIZIMI I BUJQVE NË SHOQATA DHE KOOPERATIVA

Këto grupe interesi, janë forma më e mirë për t'i mbrojtur interesat e përbashkëta të bujqve para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, për lobim, kërkim për tregun e përbashkët për prodhimet dhe furnizim me repromaterjle, promovim dhe marketing të prodhimeve.

# 12

## SUBVENCIONE PËR FERMERËT

Do të kërkojmë që 30 milion euro në çdo vit të shkojnë në subvencione për fermerët shqiptarë, me fokus nxitjen e ndërmarrjeve private të bashkëpunimit, apo kooperativave private bujqësore, sipas modeleve të suksesshme në Evropë dhe në Kosovë.

Maqedonia e Veriut, Shqipëria e Kosova duhet të jenë një treg i përbashkët bujqësor, dhe politikat tona do të jenë për rrëzimin e çdo barriere tarifore apo jotarifore midis këtyre tre vendeve, gjë që do të ndihmojë shumë edhe fermerët por edhe konsumatorët e prodhimeve tona.

Tregu bujqësor i përbashkët do të mundësonte zhvillimin e ekonomisë në atë shkallë sa mund të konkurrojë më tej edhe më gjerësisht në Ballkan e në Evropë.

Përkrahje financiare për themelimin e të paktën një qendre grumbulluese të prodhimeve bujqësore në Maqedoninë Veri-Perëndimore (mbi principin e Partneritetit Publiko Privat (PPP));

# 13

## FONDE EVROPIANE PËR FERMERËT SHQIPTARË TË MAQEDONISË

Përmes bashkëpunimit ndërkomunal, në bashkëpunim me qeverinë e VLEN, do të krijohen ekipe në secilën komunë, që do të kenë për detyrë të ndihmojnë fermerët që të aplikojnë për fondet dhe subvencionet evropiane për bujqësinë. Deri më tani ato fonde kryesisht nuk kanë shkuar në ndihmë të shqiptarëve. Tash është momenti që kjo gjë të ndryshojë.

Mbështetje financiare të organizatave që këshillojnë dhe ndihmojnë bujqit si të shesin prodhimet e veta në vend dhe jashtë vendit.

Përkrahje financiare të organizatave që ndihmojnë bujqit për aplikim në fondet IPARD dhe IPA dhe në prokurimet publike të Qeverisë.

Formim i qendrës (institut) për kërkim dhe analiza në bujqësi dhe zhvillim, edukimin dhe shfrytëzimin e potencialit njerëzor të fermerëve, trajnimin e fermerëve për shfrytëzimin e fondeve bujqësore (IPARD, IPA, etj.) dhe resurseve natyrore. Instituti do të kujdeset edhe për standardizimin e prodhimeve ushqimore, seleksionimin dhe ruajtjen e potencialit gjenetik autokton të kafshëve si dhe zhvillimin e turizmit malor dhe agroturizmit si vlerë e shtuar në zhvillimin rural.

# 14

## NGRITJEN E 60 AGROBIZNESEVE

Këto do të ngrihen sipas modelit të suksesshëm të Shqipërisë, ku shteti ndihmon investitorin privat duke ia kthyer gjysmën e investimit, nëse ai funksionon me sukses për vitin e parë dhe nëse prodhimet janë mbi 70% lokale.

Ngritja e 60 agrobizneseve në vendbanimet shqiptare do të shoqërohet edhe me restaurimin e rregullimin e infrastrukturës në ato 60 vendbanime, gjë që do të kontribuojë shumë në rritjen e interesit të turistëve për pjesët jo shumë të njohura të Maqedonisë së Veriut.

# 15 LEHTËSIMI I QASJES NË MJETE TRANSPORTUESE

- Kthimi i TVSH-së për veturat e vogla të kompanive, sepse shumica shërbejnë për vetë bizneset;
- Ulja e taksës rrugore për 50%;
- Kartoni i gjelbër 1 euro;
- Lirimi i homologimit për automjetet e reja.



Plan  
2030  
VLEN

# VIII. INTEGRIMI KOMBËTAR

  
ALEANCA PËR SHQIPTARËT

  
ALTERNATIVA

  
LËVIZJA  
BESA

  
LËVIZJA  
DEMOKRATIK

## VIII. INTEGRIMI KOMBËTAR

# 1 EUROREGJIONE QË NA AFROJNË ME SHQIPËRINË DHE KOSOVËN

Ne do të angazhohemi për Krijimin e tre Euroregjioneve të reja:

- Euroregjioni i Maleve të Sharrit e të Korabit, me bashkëpunimin e Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë.
- Euroregjioni i Karadakut të Shkupit, i cili do të përfshijë Kumanovën e komunat përreth, Luginën e Preshevës, si dhe Gjilanin e komunat përreth.
- Euroregjioni i Liqeneve, me përfshirjen e Strugës, Ohrit, Resnjes, si dhe komunave të Shqipërisë e të Greqisë që ndodhen breg liqeneve të Ohrit e Prespës.

Euroregjionet nuk kanë natyrë politike, por kanë mundësi të mira bashkëpunimi e financime për zhvillim infrastrukturor, aktivitetet biznesor dhe kulturor.

Euroregjione të tillë ekzistojnë tashmë në rajonet maqedonase, njëri së bashku me Serbinë e Bullgarinë, e tjetri së bashku me Bullgarinë e Greqinë.

## 2 ZONAT E LIRA EKONOMIKE NDËRKUFITARE

Ne do të angazhohemi për themelimin e katër zonave të lira ndërkufitare, që ndihmojnë tregtinë, bashkëpunimin ekonomik dhe investimin, midis Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë, Kosovës dhe Luginës së Preshevës. Ato janë:

- Zona e Lirë Ekonomike Ndërkufitare e Bllacës dhe Hanit të Elezit;
- Zona e Lirë Ekonomike Ndërkufitare e Kumanovës, Gjilanit dhe Preshevës,
- Zona e Lirë Ekonomike Ndërkufitare e Strugës dhe Pogradecit,
- Zona e Lirë Ekonomike Ndërkufitare e Dibrës dhe Peshkopisë.

Zona të tilla mund të zhvillohen edhe në pjesën e malësisë së Sharrit, ku fokusi do të jetë turizmi malor dhe ekonomia e përpunimit të mishit dhe prodhimeve blegtorale.

Këto zona do të sjellin zhvillim në krahina që kanë mbetur pa përparim ekonomik dhe që deri më tash janë lënë në harresë të plotë. Këto zona janë ftuese për investime, krijojnë punësim, dhe zvogëlojnë emigrimin. Në teorinë ekonomike ato njihen si mundësi të mira zhvillimore për bizneset, sepse shfrytëzojnë avantazhet konkurruese, burime dhe mundësi nga dy shtetet që janë kufizuese të njëra-tjetrës. Këto zona do të jenë të përkrahura me politika speciale financiare, tatimore, investuese, rregullativa të veçanta doganore etj.

# 3

## NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS RRUGORE KOMBETARE

VLEN konsideron prioritet kombëtar që brenda mandatit të ardhshëm:

- Të perfundohet Korridori 8, duke përfshirë transportin hekurudhor dhe atë rrugor, si edhe portin e thatë në Strugë. Korridori 8 do ta sjellë Shqipërinë më pranë nesh dhe Maqedoninë e Veriut më pranë Adriatikut.

- Përfundimin e shpejtë të autostradës Shkup-Bllacë dhe të rrugës Prizren-Tetovë.

- Projektimin dhe ndërtimin e rrugës Gjilan-Kumanovë dhe Dibër-Peshkopi.

- Rregullimin e rrugëve anësore përreth magjistrales Gostivar-Tetovë-Gostivar, me qëllim të zhvillimit të biznesit përreth magjistrales;

- Hapja e terminalit doganor në Jazhincë, përmes të cilit do të mundësohet doganimi i mallrave dhe shërbimeve dhe do të sigurohet rritje direkte ekonomike e rajonit.

Infrastruktura që ne dëshirojmë, si shqiptarë të Maqedonisë së Veriut, është ajo që na afron me shqiptarët e tjerë.

# 4

## INTEGRIM NDËRSHQIPTAR NË ÇDO SEKTOR JOPOLITIK

Politikisht, si shtet Maqedonia e Veriut është integruar në bllokun euroatlantik, në NATO dhe do të integrohet në Bashkim Evropian.

VLEN do të angazhohet edhe për integrimin kombëtar shqiptar në fushat me afinitetit të veçantë kulturor dhe ekonomik:

- Në aspektet e sportit, arsimit, kulturës, shkollave, pjesërisht edhe biznesit e tregjeve të ndryshme.

- Tregu i përbashkët bujqësor, Banka Shqiptare, Qendra e Trajnimeve për Mësuesit, Instituti Pedagogjik, Shkollat për Mërgatën, Kupat Sportive, Olimpiadat e Konkursset shkollore, të gjitha këto janë iniciativa që do t'i bëjmë në bashkëpunim me qeveritë e Kosovës dhe të Shqipërisë.

Ky lloj bashkëpunimi do të ruajë identitetin tonë kombëtar që të mos rrezikojmë asimilimin apo prapambetjen, do të ruajë traditat tona për të cilat jemi krenarë.

## 5 ZBULIMI, RUAJTJA DHE GJALLËRIMI I TRASHEGIMISË SONË KULTURORE

Përparësi me politikat e trashëgimisë e të kulturës do t'i japim zhvillimit në Maqedoninë e Veriut të albanologjisë, arkeologjisë, antropologjisë dhe studimeve etnografike, në bashkëpunim ndërinstitucional mes Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit.

## 6 AFIRMIMI I KULTURËS SHQIPTARE

Themelimi i Muzeut të Historisë dhe Kulturës Shqiptare. Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut akoma nuk kanë asnjë muze, ku do të tubohen dhe ruhen artefakte që dëshmojnë për autoktoninë shqiptare në këto treva, por edhe të periudhave më të vonshme të historisë. Gjithashtu aty do të duhet të konservohen edhe artefaktet e jetës kulturore e shpirtërore të shqiptarëve në këtë shtet. Muzetë do të ndërtohen në bashkëpunim me qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës.

Do të shihet mundësia edhe për muze të tjerë të përbashkët dhe rrite të investimeve në infrastrukturën e kulturës me theks të veçantë në këto projekte prioritare:

- Përfundimi dhe futja në funksionim e godinës së teatrit dhe bibliotekës së Tetovës.
- Ndërtimi ose gjetja e hapësirës për ushtrimin e veprimtarisë në mënyrë dinjitoze të Ansambli shtetëror i këngëve dhe valleve popullore shqiptare në RMV.
- Krijimi i hapësirave për Teatrin Shqiptar për Fëmijë dhe të Rinj.
- Rinovimi i Pallatit të Kulturës të Gostivarit, të Tetovës, Strugës dhe i Teatrit të Kumanovës.

## 7 ORGANIZIMI I LOJERAVE PANSHQIPTARE

VLEN angazhohet që lojrat panshqiptare të organizohen çdo vit, duke përfshirë sportet tradicionale ku mund të marrin pjesë edhe popuj e kombe të tjera, por ku respektohen rregullat e lojërave sipas traditave folklorike shqiptare. Këto lojëra do të promovojnë jetën e shëndetshme, sportin, miqësinë dhe paqen, si dhe do të jenë një pasaportë e mirë për kulturën fizike shqiptare kudo në botë.

## 8 TUR ÇIKLISTIK I KATER SHTETEVE

Me bashkëpunim të federatave të çiklizmit por edhe të qeverive e të komunave, do të organizojmë një tur të përvitshëm çiklistik që fillon në Ohër, përshkon Maqedoninë së Veriut, vazhdon drejt Kosovës, më pas drejt Malit të Zi, e më tej zbret drejt Shqipërisë e përfundon në Sarandë. Ky tur çiklistik do të ketë pjesëmarrjen e çiklistëve nga e gjithë bota, do të promovojë bukuritë turistike të katër vendeve, dhe nuk do të ketë asgjë më pak se turet e famshme të Francës, Italisë apo Spanjës.

## 9 ERASMUS SHQIPTAR

Ministria e Arsimit në qeverinë e VLEN do të bëjë marrëveshje me Kosovën e Shqipërinë, që studentët tanë të kenë mundësi për të zhvilluar një vit universitar në njërin nga universitetet e Kosovës e të Shqipërisë.

Këto programe i ndihmojnë mobilitetit të studentëve, e në të ardhmen edhe mobilitetit shoqëror e atij ekonomik, në një treg pune që do të jetë gjithmonë e më i integruar.

Plani<sup>6</sup>  
2030  
VLEN

# IX. INTEGRIMI EVROPIAN, DREJTËSIA DHE SIGURIA

## IX. INTEGRIMI EVROPIAN, DREJTËSIA DHE SIGURIA

1

### PËR NDRYSHIMET KUSHTETUESE

Koalicioni VLEN e ka bërë të qartë se qëndron fort për dryshimet kushtetuese, dhe atë sa më shpejt.

Ndryshimet kushtetuese duhet të reflektojnë edhe kërkesat e interesat e shqiptarëve dhe të sjellin Kushtetutën në përputhje me realitetin dhe me demokracinë konsensuale.

Kushti ynë për ndryshimet kushtetuese është që në Kushtetutën e ndryshuar gjuha shqipe të përmendet me emër e jo si si gjuhë që e flasin së paku 20% e popullatës dhe që dallon nga maqedonishtja.

2

### JEMI KOMB EVROPIAN DHE PRANDAJ SUBJEKT EVROPIAN

Si koalicion me përcaktim të padiskutueshëm evropian, shprehim vendosmërinë tonë kombëtare e programore, në politikën tonë të brendshme e të jashtme:

- Për afrimin me shtetet anëtare të BE në rajonin tonë;
- Për harmonizimin e plotë të politikës sonë me BE dhe NATO;
- Distancimin e qartë të MV prej vendeve me qëndrime të qarta anti-BE dhe anti-NATO, siç është në rajonin ballkanik Serbia, apo më larg Rusia, Kina, Irani e vende të tjera;
- Bashkëpunimi në rrafshin e sigurisë me vendet fqinjë si Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Kosova, por edhe vendet e rajonit si Kroacia, Mali i Zi, Rumania e Turqia, do të jetë gjithnjë intensiv dhe i pandërprerë në mandatin e VLEN-it.
- Dalje nga nisma Ballkani i Hapur që konsiderojmë se është nismë kundër BE-së dhe kundër NATO-s.

# 3

## SHQIPTARËT PËR REND E SIGURI

- Ministria e Brendshme të drejtohet nga një shqiptar.
- Njëra prej dy drejtorive kryesore të saj duhet të drejtohet nga një shqiptar, ose drejtorja e shërbimit inteligjent, ose drejtorja e policisë.
- Vendosjen e shqiptarëve në pozita drejtuese brenda shërbimeve inteligjente, përfshirë ato ushtarake dhe të Presidentit.

# 4

## DËMSHPËRBLIM PËR TË PËRNDJEKURIT POLITIKË

Me kornizën negociuese parashihet hapja e dosjeve të shërbimit jugosllav. Ky proces duhet të sjellë drejtësi për mijëra të përndjekur shqiptarë që kanë vuajtur në burgjet e komunizmit jugosllav. Ata dhe familjet apo trashëgimtarët e tyre duhet të marrin mirënjohje dhe dëmshpërblim për burgun e padrejtë që kanë bërë.



Plani<sup>6</sup>  
2030  
VLEN

# X. SHTETI I SË DREJTËS

  
ALEANCA për SHQIPTARËT

  
ALTERNATIVA

  
LËVIZJA  
BESA

  
LËVIZJA  
DEMOKRATIK

## X. SHETETI I SË DREJTËS

### 1 EVROPIANIZIMI I DREJTËSISË

Në 8 vitet e fundit, vendi ka pësuar rëniet më të mëdha si në demokratizim ashtu edhe në luftën kundër korrupsionit. Gjyqësori kurrë nuk ka qenë më i kapur dhe më jofunksional, me shumicën dërrmuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve që janë vetë të korruptuar dhe nën kontrollin e pushtetit. Vazhdimi i pandëshkueshmërisë në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, veçanërisht në segmentin e pushtetit, dhe drejtësia selektive në rastet e montuara politike kanë sjellë një gjendje ku vetëm 2% e qytetarëve i besojnë drejtësisë.

VLEN angazhohet për krijimin e një trupe të përkohshme ekspertësh perëndimorë, kryesisht nga vendet evropiane, që do të integrohen në këshillat prokuroriale e gjyqësore të Maqedonisë së Veriut për një mandat gjashtëvjeçar. Kjo trupë do të monitorojnë punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve vendas, por do të kontribuojnë edhe vetë si gjyqtarë e prokurorë. Rrogat e tyre do të paguhen nga Maqedonia e Veriut, por do të kërkohet edhe ndihma e vendeve partnere.

### 2 REFORMË DHE VETING

Një pako legjislativë për reformimin e tërësishëm të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë, duke përfshirë:

- Ligj për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshirë krijimin e një organi të pavarur i themeluar enkas për këtë proces, në përputhje me standardet evropiane dhe me asistencë ndërkombëtare.
- Reformimin e sistemit për zgjedhjen, avancimin, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, përfshirë edhe Prokurorin Publik Shtetëror, për të siguruar që pavarësia e pushtetit gjyqësor të respektohet dhe promovohet në të gjitha nivelet.
- Digjitalizimin e plotë të gjykatave në përputhje me Kornizën Strategjike të Këshillit të Evropës, me fokus në optimizimin e operacioneve të gjyqësorit dhe introperabilitetin ndërmjet institucioneve.

# 3 PA KOMPROMIS KUNDËR KRIMIT DHE KORRUPSIONIT

Një pako legjislativë për luftë të pakompromistë kundër krimit dhe korrupsionit, duke përfshirë:

- Miratimin urgjent të Ligjit për Zyrën për Rikuperimin e Pasurive. Kjo do të kërkojë sjelljen e normave të reja legjislativë, veçanërisht kthimin mbarsht të ngarkesës së provës për origjinën e pasurive dhe konfiskimin paraprak në rastet e pasurisë së pashpjegueshme, në përputhje me “acquis communautaire” të BE-së. Konfiskimi i asetëve kriminale duhet të bëhet prioritet strategjik dhe të gjeneralizohet në procedurat penale për lëndë të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë (në vitin 2021, kanë qenë vetëm katër raste të konfiskimit të pasurisë së paligjshme, me vlerë të përgjithshme prej rreth 256,000 euro);
- Forcimin e kompetencave dhe burimeve të Agjencisë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar, për të mundësuar sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive kriminale;
- Forcimin e kompetencave ligjore të organeve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesit, veçanërisht Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KshPK), Policisë Financiare dhe Entit Shtetëror të Revizionit;
- Miratimin e ligjit të ri për kontrollin e brendshëm financiar publik (KBFP);
- Krijimin e Rrjetit Koordinues Antimashtrim me synim të parandalimit, menaxhimit dhe raportimit të parregullsive që prekin fondet e BE-së.
- Miratimi i një strategjie nacionale për blockchain. Kjo strategji do të rrisë drejtësinë dhe efikasitetin e sistemeve qeveritare, duke reduktuar njëkohësisht mundësitë për korrupsion. Ajo do të përmirësojë transparencën dhe llogaridhënien e proceseve të prokurimit, ndërkohë që do të përmirësojë sistemet e pronësisë dhe të regjistrimit të tokës, duke thjeshtuar proceset e gjata dhe duke mbrojtur të drejtat e njerëzve, si mbrojtja e të dhënave dhe privatësisë.

# 4

## PËRGJEGJËSI PENALE PËR PRONAT E PËRFITUARA PALIGJSHËM

- Kornizë e re ligjore për hetimin e rasteve të keqpërdorimeve (pjesa e shtuar nga materialet e LD)
- Amandament për plotësimin e neneve 52 dhe 112 të Kushtetutës
- Amendamenti do të japë një bazë kushtetuese për shqyrtimin e të gjitha procedimeve gjyqësore për personat e mëparshëm ose aktualë të zgjedhur dhe të emëruar, të cilët janë pezulluar për shlyrje të përgjegjesisë së mundshme penale
- Për këtë amandamentim do të përdoret modeli kroat, me cc'rast përfitimi i paligjshëm i pronës i arritur në procedurën e privatizimit ose operimit që lidhet me të dhe shpërdorimi i kompetencave gjatë mbrojtjes së Republikës së MV do të revokohet. Përfitimi i pronës në shkallë të gjerë në dukje disproporcional i arritur në procesin e privatizimit apo operimit lidhur me të ose mbrojtjen e Republikës së MV do të taksohet në përputhje me ligjin. Zbatimi i këtyre dispozitave nuk do të çënojë të drejtat e palëve të treta që kanë vepruar me mirëbesim

# 5

## STANDARD DHE ETIKË NË VEPRIMTARINË PUBLIKE

Do të themelohet Komisioni për Standardet në Jetën Publike, bazuar në përvojën e Mbretërisë së Bashkuar. Ky trup do të ketë për synim promovimin e etikës dhe moralit në jetën publike, më konkretisht duke i promovuar 7 parimet e Nolanit për Jetën Publike: vetëmohimi, integriteti, objektiviteti, llogaridhënia, transparenca, ndershmëria dhe lidhshëria. Komisioni do të shërbejë si organ këshillimor i Presidentit dhe organeve shtetërore përgjegjëse për shtetin e së drejtës. Komisioni do të jetë trup i pavarur që i përgjigjet Parlamentit. Kryetari i Komisionit do të zgjidhet në Kuvend dhe Komisioni do të ketë buxhetin e vetë të pavarur nga organet tjera.

# 6


## RRITJE E INVESTIMEVE NË GJYQËSOR E PROKURORI

Dyfishimin e investimeve publike në gjyqësor, në prokurorinë publike dhe në institucionet përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit, me prioritet të veçantë për Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Departamentin e Specializuar për Gjykimin e Veprave nga Sfera e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, Byronë e Sigurisë Publike, Entin Shtetëror të Revizionit dhe qendrat tjera hetimore dhe njësitë për zbatimin e ligjit të ngarkuara me hetimin e korrupsionit. Në planin afatmesëm, nevojiten reforma ligjore për të siguruar që përgatitja e buxhetit për gjyqësorin dhe institucionet kundër korrupsionit, të jetë tërësisht ose të paktën pjesërisht nën kontrollin e organeve të pavarura dhe autonome dhe jo të qeverisë, nga faza e përgatitjes së projekt buxhetit e deri në miratimin e tij nga ana e Kuvendit. Kjo do të garantojë se buxheti i këtyre institucioneve të jetë sistematikisht i mbrojtur nga ndërhyrjet politike.

# 7

## PËR PUNËSIM, TRANSPARENÇË E PLOTË

Do të themelojmë një komision shtetëror transparence, ku secili mund të ankohet nëse beson se ka pasur padrejtësi në vlerësimin që i është bërë në konkursin për punësim. Ai komision shtetëror transparence do të shqyrtojë lëndën dhe do të bëjë publike të gjitha dokumentacionet e të gjitha palëve të interesuara.



Plani<sup>6</sup>  
2030  
VLEN

# XI. SHTET DIGJITAL 2024-2028

# 1 PLAN KATËRVJEÇAR PËR DIGJITALIZIM

Duke u bazuar në strategjite dhe aktivitetet që ka marrë BE, plani ynë katërvjeçar për digjitalizimin e vendit përshkruan iniciativat dhe strategjitë kryesore për të shfrytëzuar fuqinë dhe mundësitë e digjitalizimit për të mirën e të gjithë sektorëve në vendin tonë. Ky plan do të financohet përmes formave të ndryshme, varësisht nga fusha në fjalë, përfshirë fondet e buxhetit shtetëror, siç janë Fondi për digjitalizim, Fondi i Inovacionit; grantet ndërkombëtare veçanërisht fondet evropiane si Fondet Strukturore dhe Investuese, Fondi për transformim digjital, Programet për kërkime shkencore dhe inovacion, Programi për Evropën Digjitale, Programi për shëndetësi dhe ai për Evropën Kreative. Veç kësaj, do të shfrytëzohen edhe huatë e Bankës Evropiane të Investimeve (EIB) për të ndërtuar partneritete publiko-private, pa përjashtuar edhe kontributet e sektorit privat dhe donacionet filantropike.

# 2 INFRASTRUKTURA DIGJITALE, 5G DHE FIBRA OPTIKE

Në dy vitet e para do të fokusohemi në Investimet në Infrastrukturën Digjitale ku do të alokojmë fonde të konsiderueshme drejt zhvillimit të rrjeteve me brez të gjerë me shpejtësi të lartë, duke përfshirë 5G dhe infrastrukturën me fibra optike, për të siguruar akses universal, të shpejtë dhe të besueshëm për të gjithë qytetarët në vend. Për këtë aktivitet do të shohim mundësi për nxitje të partneriteteve publike-private për të përshpejtuar vendosjen e infrastrukturës digjitale, veçanërisht në zonat rurale.

# 3

## KUALIFIKIM DHE EDUKIM

Në dy vitet e para do të zbatohet programet gjithëpërfshirëse për trajnime formale dhe joformale me qëllim trajnime dhe edukim i aftësive digjitale për qytetarët. Theks do të kenë aktivitetet rreth krijimit të programeve dhe kurrikulave me çka do të jemi të sigurt se do të zbatohen programe gjithëpërfshirëse të aftësive digjitale në shkollat fillore e të mesme, në universitete dhe në qendrat për formim profesional për të pajisur qytetarët me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të shfrytëzuar mundësit që oforn digjitalizimi.

Në këtë drejtim do të krijojmë një fond të veçantë i cili do të stimulojë bizneset që të ofrojnë trajnime të vazhdueshme digjitale për punonjësit, me fokus në përmirësimin dhe rikualifikimin e punëtorëve në fushat ku shteti jonë I ka definuar si prioritete kryesore.

# 4

## EKOSISTEMI DHE SIGURIA KIBERNETIKE

Digjitalizimi nuk është i plotë, madje është edhe i rrezikshëm pa një ekosistem të sigurt digjital. Ne do të angazhohemi për përmirësimin e sigurisë kibernetike në nivel nacional duke përfshirë zhvillimin institucional në përputhje me direktivat Evropiane, krijimin dhe implementimin e strategjisë për siguri kibernetike, planeve të reagimit ndaj incidenteve dhe mekanizmave të shkëmbimit të informacionit.

Do të investohet në krijimin e programeve të specializuara nëpër Universitete me qëllim ngritjen e kapaciteteve njerzore dhe përmirësimin e kërkimeve shkencore që lidhen me zhvillimin e teknologjive më të avancuara të sigurisë kibernetike për të mbrojtur infrastrukturën kritike, bizneset dhe individët nga kërcënimet kibernetike.

Do të ngrisim qendren kombëtare të sigurisë kibernetike për kërkime, trajnime dhe reagim ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike.

# 5

## DIGJITALIZIMI I SIPËRMARRËSISË DHE INOVACIONI

Në vitin e tretë dhe të katërt të qeverisjes do të fokusohemi në digjitalizimin e sipërmarrësisë dhe inovacionit digjital ku do të krijojmë një ekosistem mbështetës për ndërmarësit e rinj nëpërmjet programeve financiare nacionale dhe programeve për mentorim për digjitalizim të ndërmarjeve të vogla dhe të mesme.

Do të krijojmë qendra për inovacion, digjitalizim dhe ndërmarësi në të gjitha qytetet në shtet për të ndihmuar dhe përshpejtuar digjitalizimin, për të nxitur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive midis sipërmarrësve, studiuesve dhe investitorëve si dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve.

Do të krijojmë një fond për përfshirje sociale në digjitalizim për të ofruar subvencione për familjet me të ardhura të ulëta me qëllim blerjen e aksesit në internet dhe kompjuter personal.

# 6

## GJITHËPËRFSHIRJA

Me qëllim kapërcimin e ndarjes digjitale do të krijojmë standardet minimale që duhet të plotësohen në krijimin e shërbimeve digjitale a me qëllim shërbimi të jetë lehtë i qashtë për të gjithë kategoritë e qytetarëve tanë. Do të krijojmë qendër nacionale për të ofruar mbështetje në nivel nacional për inkluzivitet digjital por gjithashtu edhe për të kontrolluar shërbimet a i plotësojnë apo jo standardet minimale për inkluzivitet digjital. Do të krijojmë pikat e shërbimit në nivel të shtetit ku do të ndihmojnë aksesimin në teknologji dhe në shërbime digjitale për popullatën e cënueshme, duke përfshirë të moshuarit, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe qytetarët me dhunti të vogla digjitale.

Do të krijojmë një sistem nacional ku do të sigurohemi se të gjitha platformat digjitale, faqet e internetit dhe shërbimet publike të jenë të aksesueshme për të gjithë përdoruesit, pavarësisht nga aftësitë ose ekspertiza e tyre teknike.

# 7

## SHËRBIME PUBLIKE DIGJITALE

Transformimi Digjital i shërbimeve publike është një ndër proceset më të rëndësishme për ngritjen e cilësisë së shërbimeve, dhënjen e shërbimeve në kohë reale si dhe luftën kundër korrupsionit. Për këtë arsye do të bëjmë modernizimin e shërbimeve dhe proceseve qeveritare nëpërmjet adoptimit të teknologjive digjitale modern. Do të vazhdojmë në përmirësimin e platformës elektronike qeveritare, do të adaptojmë ligjet që pamundësojnë implementimin e nënshkrimit elektronik dhe do të punojmë që identiteti digjiital i qytetarit të jetë process I vetëm për identifikim në nivel nacional.

Do të promovojmë parimet për dizajn të sistemeve ku në qendër është qytetari me qëllim përmirësimin e qasjes më të lehtë në shërbimet publike.

# 8

## SHËNDETI DHE MIRËQENIA DIGJITALE

Do të shfrytëzojmë potencialet e teknologjive në mjeksi të tilla si telemjekësia dhe aplikacionet në mjekësi, për të përmirësuar ofrimin e kujdesit shëndetësor, për të promovuar kujdesin parandalues dhe për të lehtësuar proceset me qëllim që institucionet shëndetësore dhe pacientët të menaxhojnë në mënyrë efektive. Do të punojmë fort në sigurimin e ndërveprimit dhe sigurisë së sistemeve të të dhënave shëndetësore për të lehtësuar shkëmbimin e pandërprerë të të dhënave ndërmjet pacientit dhe institucionit shëndetësor dhe për të përmirësuar interakcionin pacient institucion shëndetësor.

# 9

## INTELIGJENCA ARTIFICIALE DHE QEVERISJA DIGJITALE

Do të nxisim që çdo institucion të krijojë udhëzime, rregullore dhe kornizë etike për zhvillimin dhe vendosjen e përgjegjshme të teknologjive me theks të veçantë të inteligjencës artificiale, duke siguruar transparencë, llogaridhënie dhe drejtësi. Në këtë drejtim do të krijojmë program për investime në kërkime dhe inovacione për të adresuar implikimet etike dhe shoqërore të inteligjencës artificiale, duke përfshirë parajkykimet, diskriminimin dhe transparencën algoritmike.

# 10

## KULTURA DIGJITALE DHE KREATIVITETI

Do të mbështesim institucionet kulturore dhe krijuese në shfrytëzimin e teknologjive digjitale për të inovuar, krijuar forma të reja shprehjeje dhe për të arritur audiencë më të gjerë. Do të krijojmë program për promovimin e shkrim-leximit digjital dhe iniciativa për ruajtjen e trashëgimisë kulturore duke digjitalizuar ato.



Plani<sup>6</sup>  
2030  
VLEN

## XII. MJEDISI

## 1 ENERGJIA E PASTËR

Do t'i japim përparësi energjisë që vjen nga burimet e rinovueshme, si dielli, era dhe hidro, me impakt sa më të vogël mjedisor.

Për amvisëritë dhe industrinë e vogël - do të stimulojmë instalimin e paneleve diellore në çati.

Do të synohet efikasiteti energjetik - mbështetja dhe subvencionimi i projekteve që do të mundësojnë shfrytëzim efikas të energjisë dhe mbrojtje të mjedisit jetësor.

## 2 SIGURIA AMBIENTALE

Do të vendosim ligje që rregullojnë përdorimin e teknologjive industriale që zvogëlojnë ndjeshëm ndotjen, dhe do të ndalojmë operimin e çdo lloj biznesi që nuk e merr parasysh nevojën për zvogëlim të ndotjes.

Do të nisim aksione të ripyllëzimit të kodrave e maleve tona;

Do të vendosim një standard gjelbërimi për çdo zonë urbane në shtetin tonë. Koeficienti i ndërtimit në zonat urbane nuk duhet të jetë më i lartë se 0.5, dhe pjesa tjetër do të lihet për gjelbërim dhe ambiente rekreative.

# 3

## SIGURIA CIVILE

Instalimi i sistemeve të sigurisë nga zjarrin në të gjitha institucionet, e sidomos në ato të shërbimeve publike arsimore e shëndetësore, por edhe në ato private si supermarketet apo qendrat tregtare, investimi për modernizimin e trupave dhe pajisjeve të zjarrfikëseve, si dhe trajnimi i përvitshëm për situatat e ndryshme që krijohen nga aksidentet njerëzore apo ato natyrore.

# 4

## QËNDRUESHMËRIA DIGJITALE DHE TEKNOLOGJIA E GJELBËR

Nxitja e inovacionit në teknologjinë e gjelbër dhe zgjidhjet digjitale për të adresuar sfidat mjedisore dhe për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm është një nga shtyllat kryesore për të krijuar një ambient më të pastër dhe inovativ për qytetarët e RMV, për këtë arsye do të inkurajojmë adoptimin e mjeteve dhe praktikave digjitale që reduktojnë konsumin e energjisë, minimizojnë mbetjet dhe optimizojnë përdorimin e burimeve energjetike, duke shfrytëzuar programet e financimit siç janë Europa Digjitale, Green Deal Fund i BE-së dhe buxhetin shtetëror.

Ardhmëria jote  
dhe e familjes

**VLEN**

Vota jote vlen,  
voto  
numrin

6

# Plani<sup>6</sup> 2030 VLEN